

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

Maj 2026

BULETINI

M U J O R



01



FORCAT E ARMATOSURA DHE GARDA KOMBËTARE E NJU XHERSIT, NJË ÇEREK SHEKULLI PARTNERITET

Forcat e Armatosura të Shqipërisë dhe Garda Kombëtare e Nju Xhersit shënojnë 25 vite partneritet të qëndrueshëm dhe të suksesshëm në kuadër të Programit të Partneritetit Shtetëror. Me këtë rast, Shqipërinë e vizitoi një delegacion i SHBA, i kryesuar nga komandantja e Gardës Kombëtare të Nju Xhersit, gjeneral brigade Yvonne Mays.





VIZITË NË AMBIENTET E REJA NË FAKULTETIN E MBROJTJES DHE SIGURISË

Ministri i Mbrojtjes, z. Ermal Nufi inspektoi punimet pranë Akademisë së Forcave të Armatosura, ku po përmbyllen fazat e fundit të projektit. Gjatë vizitës, u bë e ditur se studentët do ta nisin vitin e ri akademik në tetor në një kampus të ri, modern dhe sipas standardeve bashkëkohore të institucioneve ndërkombëtare të mbrojtjes dhe sigurisë.





MINISTRI NUFI MIKPRET DELEGACIONIN E SHËRBIMIT EVROPIAN TË VEPRIMIT TË JASHTËM

Ministri i Mbrojtjes, z. Ermal Nufi mikpriti Drejtorin për Paqen, Partneritetet dhe Menaxhimin e Krizave në Shërbimin Evropian të Veprimit të Jashtëm (EEAS), z. Cosmin Dobran. Gjatë takimit u vlerësua Partneriteti për Siguri dhe Mbrojtje, si një platformë praktike për bashkëpunim të strukturuar, ku Shqipëria është plotësisht e angazhuar për vazhdimin e këtij dialogu dhe arritjen e rezultateve konkrete.





MINISTRI NUFU MIKPRET SHEFIN E SHTABIT TË MAQEDONISË SË VERIUT

Ministri i Mbrojtjes, z. Ermal Nufi mikpriti Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Maqedonisë së Veriut, gjeneralmajor Sashko Lafchiski. Përgjatë takimit u nënvizua rëndësia e bashkëpunimit të ngushtë për Korridorin VIII, si një hap kritik për lëvizshmërinë ushtarake dhe sigurinë në Ballkanin Perëndimor. Palët vlerësuan se si aleatë të NATO-s, janë të përkushtuara në ruajtjen e paqes, stabilitetit dhe sigurisë në Ballkanin Perëndimor dhe në të gjithë kontinentin Evropian.





STËRVITJA “REDONI GODITËS 2026”

“REDONI GODITËS 2026” nuk ishte thjesht stërvitje rutinë, por demonstrim force dhe testim kapacitetesh mes Forcës Detare, Forcës Ajrore, Regjimentit të Operacioneve Speciale, Policisë Kufitare dhe Migracionit dhe Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare. Në fokus ishte planifikimi, koordinimi, ekzekutimi dhe shpejtësia e reagimit në operacionet e ndalimit detar (MIO), si dhe në zbatimin e ligjshmërisë në hapësirën detare.





NUFI MIKPRET NË TIRANË KOMANDANTIN E KOMANDËS SË FORCËS SË BASHKUAR TË NATO-S NË NAPOLI

Ministri i Mbrojtjes, z. Ermal Nufi ka mikpritur komandantin e Komandës së Forcës së Bashkuar në Napoli (Allied Joint Force Command Naples), admiralin Xhorxh M. Uikof (George M. Wikoff), i cili erdhi në Shqipëri për një vizitë zyrtare. Gjatë takimit, Ministri Nufi theksoi se kjo vizitë e rëndësishme pasqyron partneritetin e qëndrueshëm mes Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe aleatëve në NATO-s, duke nënvizuar se vendi ynë mbetet plotësisht i angazhuar ndaj mbrojtjes kolektive dhe vlerave të përbashkëta demokratike.





MINISTRI NUFI KONFERENCË PËR MEDIAT

Ministri i Mbrojtjes, z. Ermal Nufi prezantoi në një konferencë për media, prioritetet strategjike dhe angazhimet kryesore të Ministrisë së Mbrojtjes në fushën e sigurisë kombëtare, modernizimit të Forcave të Armatosura dhe menaxhimit të emergjencave civile. Ai theksoi se Shqipëria mbetet një aleat i palëkundur i NATO-s dhe një partner aktiv në sigurinë rajonale dhe ndërkombëtare.





NUFI: ANGAZHIM MAKSIMAL NË FORCIMIN E KAPACITETEVE PËR ZVOGËLIMIN E RISKUT NGA FATKEQËSITË

Gjatë vizitës në Bazën e Mbështetjes për Emergjencat Civile (BMEC), Ministri Nufi u takua me efektivët e Forcave të Armatosura, që angazhohen çdo ditë në ndihmë të komunitetit për përballimin e situatave të vështira emergjente, me theks të veçantë te reagimi ndaj zjarreve gjatë sezonit veror. Nufi u shpreh se mbetemi maksimalisht të angazhuar në forcimin e kapaciteteve për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, rritjen e gatishmërisë operacionale dhe garantimin e një reagimi të shpejtë dhe efektiv, për të qenë pranë qytetarëve në çdo situatë emergjente.





PREZANTOHET DREJTUESI I RI I INSTITUTIT TË GJEOGRAFISË DHE INFRASTRUKTURËS USHTARAKE (IGJIU)

Në ambientet e Institutit të Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake (IGJIU) u prezantua në prani të Zëvendësministrit të Mbrojtjes z. Enkelejdi Joti, drejtori i ri, z. Besnik Hysaj. Z. Joti duke nënvizuar nivelin e lartë të profesionalizmit të stafit të IGJIU, shtoi se Ministria e Mbrojtjes do të vijojë ta mbështesë aktivitetin e institutit, me synimin për të forcuar më tej rolin e tij në mbështetje të Forcave të Armatosura.





PËRFUNDON KURSI I XVI I LARTË I SIGURISË DHE MBROJTJES, ABRAZHDA: SHQIPËRIA, PIKË TAKIMI PËR SIGURINË DHE MBROJTJEN

Ushtarakë të lartë nga FA, përfaqësues të vendeve të NATO-s dhe profesionistë civilë të fushës së sigurisë, përfunduan me sukses Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes, i zhvilluar pranë Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë. Në fjalën e saj përshëndetëse, Zëvendësministria e Mbrojtjes znj. Blerina Abrazhda tha se gjatë këtyre muajve, Shqipëria u bë një pikë takimi ku oficerë dhe profesionistë nga e gjithë Evropa dhe Lindja e Mesme u ulën bashkë, punuan bashkë dhe mësuan nga njëri-tjetri.





GJENERALLEJTËNANT KINGJI MERR PJESË NË “DITËN E VIZITORËVE TË SHQUAR” TË STËRVITJES “EFES-2026” NË TURQI

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjenerallejtënant Arben Kingji, mori pjesë në aktivitetin “Dita e Vizitorëve të Shquar”, në kuadër të përmbylljes së stërvitjes shumëkombëshe “EFES-2026” në Izmir, Turqi. “EFES-2026” është një nga stërvitjet më të rëndësishme shumëkombëshe të drejtuara nga Forcat e Armatosura turke, me pjesëmarrjen e mbi 10 mijë trupave turke dhe ndërkombëtare, ku Shqipëria u përfaqësua me 70 efektivë nga FARSH.





MINISTRI NUFI MIKPRET HOMOLOGUN GREK DENDIAS

Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, z. Ermal Nufi mikpriti homologun e tij, Ministrin e Mbrojtjes Kombëtare të Greqisë, z. Nikos Dendias. Në fokus të kësaj vizite zyrtare ishte forcimi i bashkëpunimit dypalësh Shqipëri-Greqi dhe vijimi i dialogut të ngushtë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Duke e vlerësuar mbështetjen e Greqisë për rrugëtimin evropian të Shqipërisë, z. Nufi u ndal tek promovimi i stabilitetit dhe sigurisë rajonale, veçanërisht në Ballkanin Perëndimor, i cili mbetet prioritet strategjik i përbashkët i dy vendeve tona.





30-VJETORI I QENDRËS SË GJUHËVE TË HUAJA

Qendra e Gjuhëve të Huaja, pranë Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, festoi 30-vjetorin e themelimit. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, mori pjesë edhe Zëvendësministria e Mbrojtjes znj. Pranvera Skana, e cila u shpreh se për tre dekada, ky departament ka bërë një punë të jashtëzakonshme duke përgatitur oficerë dhe drejtues që kanë përfaqësuar me krenari Forcat tona të Armatosura në misione ndërkombëtare, në selinë e NATO-s dhe në forume kyçe të sigurisë globale.



FERDINAND DIMO MERR DREJTIMIN E KOMANDËS SË AFA

Gjeneralmajor Ferdinand Dimo ka marrë zyrtarisht drejtimin e Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA), pas dorëzimit të komandës nga gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj. Në fjalën e tij, Ministri Nufi vlerësoi kontributin e gjeneral Nuredinaj në drejtimin e Akademisë, duke theksuar zhvillimet e rëndësishme të institucionit në konsolidimin akademik, forcimin e kërkimit shkencor dhe avancimin e projekteve infrastrukturore.





KËSHILLI I MINISTRAVE, 3 VENDIME QË LIDHEN ME MINISTRINË E MBROJTJES

Në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të zhvilluar me datë 28 maj, u miratuan tre vendime të rëndësishme që lidhen me Ministrinë e Mbrojtjes. U miratuan ndryshimet për njësimin e gradave ushtarake me strukturën aktuale të Forcave të Armatosura, me synim më shumë qartësi dhe efikasitet në organizim. Një tjetër vendim ishte aprovimi për financimin e 44 projekteve në përballimin e fatkeqësive natyrore në vitin 2026. Gjithashtu, Këshilli i Ministrave mori vendim që pjesëmarrja e efektivëve tanë EOD në misionin e NATO-s në Letoni të zgjatet deri më 31 dhjetor 2029, duke vijuar kontributin në sigurinë kolektive dhe në forcimin e krahut lindor të NATO-s.





VIZITË NË SPITALIN FUSHOR NË ZALL-HERR

Ministri i Mbrojtjes, z. Ermal Nufi zhvilloi një vizitë në Komandën e Forcës Tokësore në Zall-Herr, ku ndoqi nga afër simulimin dhe vizitoi Spitalin Fushor të Grup Batalionit të Këmbëtorisë së Lehtë (GBKL). Gjatë aktivitetit u prezantuan kapacitetet operacionale të Spitalit Fushor ROLE 2, si dhe u realizuan demonstrime praktike të operacioneve CASEVAC dhe MEDEVAC për evakuimin dhe trajtimin e të plagosurve.





MONS, BELGJIKË / MINISTRI NUFI TAKON KOMANDANTIN SUPREM TË NATO-S, GJENERAL ALEXUS G. GRYNKEWICH

Ministri i Mbrojtjes, z. Ermal Nufi zhvilloi një vizitë zyrtare në Shtabin Suprem të Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE), ku u prit nga Komandanti Suprem i Forcave Aleate në Evropë, gjeneral Alexis G. Grynkewich. Palët diskutuan ndër të tjera edhe për Bazën Detare të Porto Romanos dhe mobilitetin përgjatë Korridorit VIII, disa prej projekteve madhore, për të cilat vendi ynë po bën investime të rëndësishme në infrastrukturën strategjike në forcimin e lëvizshmërisë së NATO-s, ndërveprueshmërisë dhe gatishmërisë operacionale.






MINISTRI NUFI NË BRUKSEL, TAKIM ME ZËVENDËSSEKRETAREN E PËRGJITHSHME TË NATO-S, RADMILA ŠEKERINSKA

Në fokus të diskutimeve me Zëvendëssekretaren e Përgjithshme të NATO-s, znj. Radmilla Shekerinska (Radmila Šekerinska) ishin sfidat aktuale të sigurisë dhe roli në rritje i Shqipërisë brenda Aleancës. Vendi ynë vijon të kontribuojë me përkushtim në mbrojtjen kolektive, duke u konsoliduar si një faktor stabiliteti dhe pikë referimi për sigurinë në rajon. Gjatë takimit, palët theksuan bashkërisht rëndësinë e punës për organizimin e Samitit historik të NATO-s në Tiranë në vitin 2027-të, si një moment kyç gjithashtu për rolin dhe kontributin e Shqipërisë në Aleancë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

